



NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT, DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHITETET KU ATA BANOJNË

#122

AKD nis të hënën cikël aktivitetesh me arbëreshët e Italisë



“Tinguj jete midis tokës dhe detit” është një program aktivitetesh që do të realizohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës në Komunitetin Arbëresh në datat 30-31 gusht dhe 1 shtator.

Aktivitetet do të realizohen në dy vende në Horën e Arbëreshëve në Siçili dhe në Cerzeto në Kalabri, dhe përfshijnë takime me përfaqësues të këtij komuniteti dhe ku do të diskutohen çështje me elementët kulturorë, antropologjik, historikë që bashkojnë veçoritë midis Italisë dhe Shqipërisë ndër shekuj.



"Apliko online për rinovimim e dokumenteve biometrike"

Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë tashmë kanë mundësi të aplikojnë për rinovimim e dokumentave të tyre biometrike, si dhe të deklarojnë adresën e tyre të vendbanimit online.

Reja e magjishme e arbëresheve Shega

Mbrëmjen e të mërkurës për herë të parë që nga krijimi i tyre grupi muzikor arbëresh Shega ka interpretuar përpara publikut shqiptar. Atmosfera ishte sa elektrizuese aq edhe e ndere. Për muzikantët që luanin për herë të parë përpara publikut të tokës amë, e për publikun që për herë të parë dëgjonte tingujt e muzikës shqiptare të paprekura në shekuj.



Aplikacioni "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare" zëri i biznesit në Diasporë

Gjithçka në "pëllëmbë të dorës" nëpërmjet aplikacionit "Dhoma e Biznesit e Diasporës Shqiptare - ADBC". Informacion të arritshëm për bizneset, sipërmarrësit, anëtarët e Diasporës në Shqipëri, si dhe funksione të ndryshme

Agjencia Kombëtare e Diasporës takim me grupin muzikor arbëresh "Shega"



Pjesëtarët e grupit Arbëresh "Shega" vizituan sot ambientet e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, ku u njohën me veprimtarinë e Agjencisë si një institucion që ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën shqiptare.

Drejtoresha Ekzekutive e AKD-së, Znj. Sonila Hysi dhe Drejtoresha e Diasporës, Znj. Klaudia Hasanllari pritën sot grupin muzikor arbëresh "Shega".

Drejtoresha Ekzekutive Znj. Hysi theksoi rëndësinë që ka komuniteti shqiptar arbëresh për shtetin shqiptar dhe shprehu mikëpritjen e Agjencisë për të gjithë arbëreshët.



Connect Albania është një program që lehtëson angazhimin e Diasporës Shqiptare që jeton jashtë vendit në zhvillimin e vendit të tyre të lindjes si agjentë zhvillimi për të tërhequr dhe rritur investimet midis komuniteteve shqiptare dhe të huaja përmes mekanizmit online

Grupi muzikor arbëresh "Shega" viziton Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Grupi muzikor arbëresh "Shega" ka zhvilluar sot një vizitë në Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) për t'u njohur me veprimtarinë e këtij institucioni. Në kuadër të turneve të tyre artistike në Kosovë dhe Shqipëri, grupi "Shega" ka zhvilluar edhe disa vizita zyrtare, me qëllimin për t'u njohur nga afër me vendin amë. Sot ata u pritën nga stafi i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe u njohën me botimet e deritanishme dhe me disa nga veprimtaritë e zhvilluara deri më tani nga ky institucion, i cili është i vetmi në trojet shqiptare që është i specializuar për studimin e historisë, gjuhës dhe letërsisë arbëreshe.



Është një platformë që synon të mbështesë e të nxisë transmetin e të dhënave profesionale duke ofruar një urë lidhëse me kapacitetet profesionet e ndryshme në Diasporë

Diaspora Shqiptare
Aplikacioni Gazeta "Diaspora Shqiptare"
SHKARKO APLIKACIONIN FALAS
App store: këtu Play store: këtu

DHURO LIBRA!
PËR SHITETASIT SHQIPTARË QË VUAJNË HEQJEN E LIRISË JASHTË VENDIT

Burgu nuk është vetëm një vend për vuajtjen e dënimit, por mund të jetë edhe letërsi, studim, rritje e njohjeve kulturore dhe ndërveprim. Nisma "Dhuro libra" do të shërbejë për krijimin e një fondi me libra shqiptarë në institucionet e vuajtjes së dënimit në Greqi dhe Itali.

BIBLIOTEKA DIXHITALE

Digitalizimi i Veprave Shqiptare
Veprat e autorëve të letërsisë shqiptare vijnë për herë të parë në formatin digjital falas për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen